

VENDIM
Nr. 59, datë 2.4.2024

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 179, DATË 8.11.2017, “MBI CERTIFIKIMIN E SHOQËRISË ‘OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR ‘ALBGAZ’ SHA”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.4.2024, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 633/3 prot., datë 29.3.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë ‘Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror ‘Albgaz sh.a.’, i ndryshuar”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 354, datë 28.12.2022, ka vendosur të ndryshojë pikën 5.2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, i ndryshuar, duke i lënë kusht shoqërisë “Albgaz” sh.a. të marrë masa për të paraqitur në ERE brenda datës 20.11.2023 provat dokumentare për bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, nenet 11 dhe 46, pika 10, e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, dhe transferimin e kompetencave te Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

- ERE, nëpërmjet shkresës nr. 71 prot., datë 11.1.2023, njoftoi shoqërinë për vendimin e sipërcituar. Në vijim me shkresën me nr. 634 prot., datë 15.2.2024, drejtuar “Albgaz” sh.a., ERE i ka kërkuar shoqërisë që të depozitojë provat dokumentare për bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, neni 11 dhe neni 46, pika 10, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, dhe transferimin e kompetencave te Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pasi nga ana e shoqërisë nuk është depozituar dokumentacioni i kërkuar brenda afatit të përcaktuar, data 20.11.2023.

- Për kushtin e vendosur në pikën 5.2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 179/2017, i ndryshuar, që lidhet me bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, neni 11 dhe 46, pika 10, e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar dhe transferimin e kompetencave te Ministria e Financave dhe Ekonomisë, shoqëria “Albgaz” sh.a. me shkresën nr. 634/1 prot., datë 21.2.2024, ka bërë me dije se për plotësimin e këtij kushti i është drejtuar zyrtarisht Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe është në pritje të një përgjigje përfundimtare, gjë e cila është përtej vullnetit të saj. Në këto rrethana, shoqëria ka kërkuar shtyrjen e afatit të plotësimit të këtij kushti deri në datën 31.12.2024.

- Duke qenë se ky kusht mbetet ende pa plotësuar, për shkaqe që nuk varen nga vullneti i shoqërisë “Albgaz” sh.a., dhe duke qenë se nga ana e shoqërisë janë bërë përpjekjet përkatëse për plotësimin e këtij kushti, vlerësohet që të merret në konsideratë kërkesa e saj për shtyrjen e afatit të plotësimit të këtij kushti deri më datë 31.12.2024.

- Në nenin 53, pika 2, e ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet, se: “Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 5.2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, i ndryshuar, bëhet si vijon:

5.2: Brenda datës 31.12.2024 shoqëria “Albgaz” sh.a. duhet të depozitojë në ERE realizimin e ndryshimeve në nenet 11 dhe 46, pika 10 ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, dhe transferimin e kompetencave të Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

2. Ky vendim i shtrin efektet duke filluar nga data 21.11.2023.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Erjola Sadushi